



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 781, datë 26.12.2018

P Ë R

**GARANTIMIN E TRANSPARENCËS NË INSTITUCIONET PUBLIKE
TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe të neneve 7, shkronjat “b” e “e”, dhe 116, pika 2, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Me qëllim garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë bën publike të dhëna/informacione në kuadër të programit të transparencës dhe të trajtimit të ankesave ndaj institucioneve të arsimit të lartë, përmbajtja e të cilave do të publikohet nga Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar në portalin e transparencës dhe të trajtimit të ankesave.
2. Portali të jetë i aksesueshëm nga të gjithë dhe në të të publikohen *on-line*:
 - a) të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të çdo institucioni të arsimit të lartë, sipas formatit të miratuar me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për financat.
Duke filluar nga viti buxhetor 2019, bordi i administrimit të institucionit të arsimit të lartë, nëpërmjet administratorit, të përcjellë çdo tre muaj, për publikim, pranë Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, të dhënat e detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare, sipas përcaktimit të kësaj shkronje;

- b) të dhëna për buxhetin afatmesëm (PBA), buxhetin vjetor, grantin nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e tjera, të gjitha shpenzimet operative, shpenzimet për kërkim shkencor dhe shpenzimet kapitale të çdo institucioni publik të arsimit të lartë;
 - c) informacion për procedurat e prokurimit publik (parashikim/realizim) apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat;
 - ç) vendimet e bordit, të senatit dhe organeve të tjera drejtuese/vendimarrëse;
 - d) kuotat e parashikuara për çdo vit akademik;
 - dh) instrumentet dhe programet e shkëmbimit studentor dhe procedurat përkatëse;
 - e) instrumentet e financimit të studimeve dhe procedurat përkatëse (bursat publike dhe ato specifike për çdo IAL);
 - ë) marrëveshjet dy-apo shumëpalëshe në nivel IAL-je apo institucione të tjera;
 - f) të dhënat për bursat dhe stimujt financiarë të ofruar nga shteti për studentët;
 - g) CV-të e pedagogëve;
 - gj) rezultatet e kontrollit dhe të verifikimit të titujve shkencorë;
 - h) mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe paraqitjen e ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e drejtuesve/organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, procedurën, nëpërmjet së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të institucionit të arsimit të lartë.
3. Për trajtimin e ankesave në platformën e transparencës *on-line*, kontrollin e transparencës dhe pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë krijohet struktura përgjegjëse për kontrollin e transparencës së arsimit të lartë.
4. Misioni i kësaj strukture është të kryejë verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, të ankimeve dhe/ose kallëzimeve për veprimtari abuzive, korruptive apo arbitrare, të identifikojë punonjësit e IAL-ve, të cilët, me veprime apo mosveprime pretendohet se kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, rritjen e efikasitetit e të përgjegjësisë në zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore.
5. Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e strukturës përgjegjëse për kontrollin e transparencës në arsimin e lartë miratohen me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

LINDITA NIKOLLA



NR.PROT. 6066/1
DATË 22.12.2018

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE
RINISË
QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË
RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË
LARTË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

